



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA MALLAKASTËR**  
**KRYETARI**

Nr. \_\_\_\_\_ Regj.  
2018

Ballsh, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .

Lënda: **Dërgohet për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, Formulari i Njoftimit të Fituesit**

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK (SPE) - TIRANË**

për ngarkim në sistemin e prokurimit elektronik të APP, në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**BASHKIA MALLAKASTËR**

Data 12.11.2018

Për: **Operatorin Ekonomik "SHENDELLI" shpk, me NIPT K07924803N, me adresë Lagjja "Kastrioti", rruga "Andon Profka", 2 kullat, Fier.**

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **"Kërkesë për propozim"**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-90408-10-18-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Sistemi i ngrohjes dhe infrastruktura e Bashkisë"**, me fond limit **9.514.648** (nëntë milion e pesëqind e katërbëdhjetëmijë e gjashtëqind e dyzetë e tetë) **lekë pa TVSH**, me afat 30 (tridhjetë) ditë.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.42, datë 22 tetor 2018

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

1. Operatori Ekonomik "GRAND KONSTRUKSION M" shpk, me NIPT L38109801T, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 9.145.425 (nëntë milion e njëqind e dyzetë e pesëmijë e katërqind e njëzetë e pesë) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik "SHENDELLI" shpk, me NIPT K07924803N, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 8.956.765 (tetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtëmijë e



shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

3. Operatori Ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” shpk, me NIPT K01529003M, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

#### **Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

##### **1. Operatori Ekonomik “GRAND KONSTRUKSION M” shpk, për arsyet e mëposhtme:**

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2.2. “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 11 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur vërtetim nga administrata tatimore të xhiros vjetore të tre viteve të fundit (2015, 2016 dhe 2017).
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 11 të dokumentave standarte të tenderit, lidhur me përvojën e mëparshme të ngjashme, pasi kontratat e paraqitura, nuk konsiderohen si punime të ngjashme pasi nuk kanë ngjashmëri me punimet objekt kontrate. Konkretisht kontrata me objekt “Masa inxhinierike për mirëmbajtjen e linjës së ujësjetillës, fshati Bence, Tepelenë”, lidhur me ShA Ujësjetillës Tepelenë nuk është kontratë e të njëjtës natyrë dhe nuk ka ngjashmëri me kontratën objekt prokurimi dhe për rrjedhim nuk merret në konsideratë për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme. Kontrata me objekt “Sistemimi i rrugëve të brendshme dhe gjelbërimi i blloqeve të banimit në qytetin e Ballshit”, lidhur me ish Bashkinë Ballsh, nuk është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nuk është kontratë e të njëjtës natyrë dhe nuk ka ngjashmëri me kontratën objekt prokurimi dhe për rrjedhim nuk merret në konsideratë për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme. Kontrata me objekt “Rikonstruksion i rrugës “Princi Boris””, lidhur me Bashkinë Mallakastër, nuk është kontratë e të njëjtës natyrë dhe nuk ka ngjashmëri me kontratën objekt prokurimi dhe për rrjedhim nuk merret në konsideratë për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 11 të dokumentave standarte të tenderit, lidhur me kategoritë e kërkuara të liçencës, pasi nuk zotëron kategorinë NP-12A dhe NS-8A.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 11 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka numrin e punonjësve të kërkuar për periudhën qershor 2017-gusht 2018.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “d”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 11 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton se ka pjesë të stafit të tij drejtuesit teknik të kërkuar si: 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier elektrik, 1 (një) inxhinier mjedisi dhe 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “e”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 11 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton se ka pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të punësuar.



- Gjithashtu nuk paraqitur dokumentacion për plotësimin e kërkesave të përcaktuara në shkronjat “f”, “g”, “h”, “l”, “n” dhe “o”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 11 të dokumentave standarte të tenderit.

**2. Operatori Ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” shpk, për arsyet e mëposhtme:**

- Nuk plotëson asnjë prej kërkesave të kualifikimit, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e tyre. Ky operator nuk ka paraqitur as ofertë ekonomike.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik "SHENDELLI" shpk, me NIPT K07924803N, me adresë Lagja "Kastrioti", rruga "Andon Profka", 2 kullat, Fier**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **8.956.765** (tetëmilion e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtëmijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mallakastër lagja “18 Prilli”, Ballsh, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 02.11.2018

Ankesa: Nuk ka patur ankesa.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Agron Kapllanaj**

